

# *Menaxhimi i mjeteve financiare të MBPZhR-së për sektorin e bujqësisë në Kosovë*

*Albanë Gashi\**

## **Abstrakt**

Sektori i bujqësisë në Kosovë ka një rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik të vendit, pasi që përmes tij mund të sigurohet një pjesë e madhe e punësimit të përgjithshëm si dhe rritja e Bruto Prodhimit Vendor. Por, pavarësisht rëndësisë që ka ky sektor në zhvillimin e vendit dhe përmirësimin e situatës së krijuar, investimet në këtë sektor dhe shfrytëzimi i potencialit të tij ende mbeten në nivel jo të kënaqshëm. Në zhvillimin e këtij sektori, padyshim se një rol i rëndësishëm i përket edhe angazhimit të organeve dhe institucioneve përgjegjëse vendore, e veçmas Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Punimi ka për qëllim që të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes aktuale të sektorit të bujqësisë dhe të rolit të saj në zhvillimin e vendit si dhe të paraqesë dhe të analizojë në baza shkencore menaxhimin e mjeteve financiare nga ana e institucioneve vendore, e veçmas të Ministrisë së përmendur më lart, në zhvillimin e këtij sektori.

Punimi bazohet në analizimin e të dhënave të prezantuara në raporte të ndryshme financiare dhe dokumentet strategjike vendore, ligje dhe rregullore në fuqi, intervista me zyrtarë përgjegjës si dhe në burime tjera shkencore relevante të kësaj fushe. Analizat në punim do të shoqërohen edhe me paraqitje tabelare dhe grafike.

**Fjalët kyç:** *sektor i bujqësisë, MBPZhR, menaxhim, mjete financiare, Kosovë.*

---

\* MA. Albanë Gashi, Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan. E-mail: gashi.albana@outlook.com

## ***Sfidat e zhvillimit të sektorit të bujqësisë në Kosovë***

Nga e tërë sipërfaqja e Kosovës vlerësohet se pjesa më e madhe është tokë e shfrytëzueshme bujqësore. Prandaj, zhvillimi i sektorit të bujqësisë konsiderohet të jetë shtytës i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit, pasi që përmes tij sigurohet pjesa më e madhe e punësimit në Kosovë me mbi 25% të punësimit të përgjithshëm, duke kontribuar me 13% në Bruto Prodhimin Vendor (më tej: BPV), ndërkaq prodhimi bujqësor përbën rreth 16% të vlerës së eksportit në total.<sup>1</sup> Në Kosovë rreth 62% e popullsisë jeton në zonat rurale prandaj sektori i bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e jetës në zonat rurale duke ofruar mundësi për punësim dhe krijimin e të ardhurave për banorët që jetojnë në këto zona.<sup>2</sup>

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme të cilat theksojnë rëndësinë e këtij sektori, dhe duke marrë parasysh se prodhimi vendor është pjesa thelbësore e zhvillimit ekonomik dhe e aktivizimit të burimeve njerëzore, Qeveria e Kosovës ka vazhduar ta mbajë sektorin e bujqësisë në fokus të prioritetëve të saj duke mbështetur financiarisht subvencionimit e fermerëve. Nisur nga fakti se Kosova vazhdon të mbetet edhe më tej në një situatë të tillë, me deficit të lartë tregtar, normë të lartë të papunësisë dhe nivel të ulët të mirëqenies së qytetarëve të saj, gjithnjë e më shumë po bëhet përpjekje që sektori i bujqësisë të shndërrohet në faktor të rimëkëmbjes ekonomike të vendit përmes avancimit të teknologjisë, shfrytëzimit në mënyrë racionale të kushteve agro-ekologjike dhe diversitetit biologjik dhe mjedisor.

---

<sup>1</sup> Ministria e Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017*, prill 2014, f. 55.

<sup>2</sup> *Ibid.*

Duhet theksuar se mbeten shumë sfida për ekonominë e vendit tonë në përgjithësi dhe sektorin e bujqësisë në veçanti. Të dhënat statistikore dëshmojnë se deficitin e vazhdueshëm tregtar tregon qartë për një bazë të dobët të prodhimit dhe konkurrueshmëri të dobët ndërkombëtare. Investimet e ulëta dhe mbështetja e lartë në remitenca (13% e BPV-së në vitin 2015) dhe ekonomia informale dëmtojnë punësimin, duke rezultuar në norma të larta të papunësisë, sidomos midis të rinjve, me një theks të veçantë tek femrat.<sup>3</sup> Kësisoj, rritja reale e BPV-së në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014, ishte 4.1%, megjithatë në aktivitetin ekonomik bujqësi, gjueti, pylltari dhe peshkim kishe rënie me (-4.1%).<sup>4</sup> Rritja e qëndrueshme ekonomike në Kosovë nuk mund të varet nga vetëm një sektor ose vetëm nga ai i bujqësisë, megjithatë ky sektor konsiderohet të ketë potencialin më të madh për përmirësimin e gjendjes ekonomike të vendit, edhe pse mbetet akoma sektori me shumë pak investime. Shkaqet për një performancë jo të kënaqshme të bujqësisë kosovare janë të shumta dhe të ndryshme.

Kosova në vitin 2007 është bërë anëtare e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore (CEFTA), e cila mundëson tregtinë e lirë midis vendeve jo anëtare të BE-së. Pavarësisht përfitimeve që ka gëzuar Kosova nga tregtia e lirë, duket se marrëveshja për tregti ka kontribuar në përkeqësimin e bilancit tregtar. Deficitin tregtar tregon se marrëveshja e tregtisë ka ndikuar në rritjen e konsumit të mallrave të importuara brenda vendit. Kështu, duke konsideruar lehtësirat të cilat kanë vendet tjera në prodhimin e mallrave të tyre, prodhuesit kosovarë po humbasin karshi mallrave të importuara. Duke marrë parasysh se tregu ynë ballafaqohet me mungesë të prodhimtarisë vendore,

---

<sup>3</sup> European Commission, *Kosovo\* 2016*, Brussels, 9.11.2016, f. 35.

<sup>4</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/bruto-produkti-vendor-bpv-sipas-aktiviteve-ekonomike-dhe-me-qasjen-e-shpenzimeve-2015>

është e rëndësishme që para se të mendohet për eksportin, t'i kushtohet rëndësi tregtisë së brendshme, duke e zëvendësuar kështu edhe importin. Përveç kësaj edhe përmirësimi i politikave fiskale në favor të prodhuesve vendorë karshi atyre të jashtëm, do të kontribuonte në përmirësimin e bilancit tregtar (30.4% e BPV në 2015) përmes zvogëlimit të importit.<sup>5</sup>

Një tjetër preokupim për sektorin e bujqësisë së Kosovës rezulton të jetë numri i madh i fermave me madhësi të vogël. Madhësia mesatare e tokës së punueshme në Kosovë rezulton të jetë 1.6 ha.<sup>6</sup> Kjo tregon se madhësia mesatare e Ekonomive Bujqësore në Kosovë për sa i përket tokës së punueshme është shumë më e vogël sesa në shumicën e shteteve të BE-së (8 herë më e vogël se mesatarja në BE), por që është e ngjashme me shtetet fqinje.<sup>7</sup> Kosova për shkak të madhësisë së vogël të fermave ka shumë vështirësi në përballimin me rrethanat që ofron tregu i lirë. Ndërkohë që madhësia më e madhe e fermës nënkupton nivele më të larta të prodhimit përmes arritjes së ekonomisë së shkallës, shfrytëzimit të teknologjive të reja, avancimeve shkencore etj., Kosova ka vetëm 5.45 % ferma me madhësi nga 5 deri në më shumë se 30 ha të Ekonomive Bujqësore.<sup>8</sup> Kjo e thekson nevojën për krijimin e kooperativave bujqësore, duke e mbështetur edhe më shumë argumentin për konsolidimin e tokës të cilën e trajton Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.<sup>9</sup> Edhe pse ky proces është i ngadalshëm, domosdoshmëria për ta zbatuar është e pashmangshme.

---

<sup>5</sup> European Commission, *Kosovo\* 2016*, Brussels, 9.11.2016, f. 35.

<sup>6</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Regjistrimi i Bujqësisë në Republikën e Kosovës 2014*, f. 46.

<sup>7</sup> *Ibid.*, f. 63.

<sup>8</sup> Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Raporti i Gjellbër 2015*, Dhjetor 2015, f. 30.

<sup>9</sup> Për më shumë rreth kooperativave shih: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Raporti i Gjellbër 2015*, dhjetor 2015, f. 31.

Sa i përket sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural vështirësitë tjera që vazhdojnë të hasen janë si më poshtë:

cilësi e ulët e prodhimeve bujqësore dhe kualiteti dhe kontrolli i dobët i ushqimit;

të hyra të ulëta në dispozicion të ekonomive shtëpiake;

nivel i ulët i edukimit në mes të bujqve dhe shërbime rurale këshilluese joadekuate si dhe mungesë konsistente e shpërndarjes së këshillave teknike;

nuk i është dhënë kujdes i mjaftueshëm menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve (një nga çështjet e parashtruara në Raportin e Progresit për Kosovën 2016, ku shprehimisht thuhet se vëllimi i prerjeve ilegale është ende shumë i lartë ).

sistem i ujitjes i varfër dhe i kufizuar në mbulim dhe teknologji;

standard i ulët i jetesës në viset rurale, sa i përket infrastrukturës fizike dhe sociale;

infrastrukturë rurale: rrugë të këqija (por duke u përmirësuar), qasje e kufizuar në ujin e pijshëm dhe mënjanim i dobët i mbeturinave, rrjeta telefonike, IT dhe rrymë elektrike të kufizuar; kreditë komerciale dhe mikrofinanciare të pavolitshme (vështirësi në qasje në financim të nevojshëm);

marketing i kufizuar dhe numër i pamjaftueshëm i pikave për grumbullimin e të gjithë artikujve me përdorim të gjerë;

administratë e dobët në nivel qendror dhe komunal.<sup>10</sup>

Edhe pse mbeten shumë sfida për t'u adresuar, mjetet e alokuara nga buxheti i vendit për sektorin e bujqësisë janë të pamjaftueshme. Vlerësohet se përderisa Kosova nuk do të gëzojë të drejtën e absorbimit të fondeve nga Instrumenti për Para-Anëtarësim për Zhvillimin Rural (IPARD)<sup>11</sup> të BE-së, buxheti i

---

<sup>10</sup> Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2010-13*, shtator 2010, f. 62-63.

<sup>11</sup> IPARD - Instrumenti për Para-Anëtarësim për Zhvillim Rural objektivat e të cilit janë (i) ndihmë në implementimin e Acquis sa i përket Politikave të

vendit nuk do të ketë kapacitetin e mjaftueshëm të trajtojë vështirësitë aktuale në fushën e këtij sektori. Në këtë rast, trajtimi i kësaj çështjeje varet nga implementimi i suksesshëm i politikave integruese me BE-në të cilat çojnë në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe rritjes së konkurrueshmërisë. Në pjesën në vazhdim do të trajtohet efikasiteti i institucionit bazë, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (më tej: MBPZhR), në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit të saj në dispozicion, në përputhje me nevojat e këtij sektori, e njëkohësisht drejt zhvillimit ekonomik.

### ***Roli i MBPZhR-së në zhvillimin e sektorit të bujqësisë***

MBPZhR-ja ka një rol të rëndësishëm në krijimin dhe zbatimin në mënyrë aktive të politikave dhe programeve në drejtim të zhvillimit të balancuar ekonomik, mjedisit shoqëror dhe kulturor, rritjes së mirëqenies në zonat rurale të Kosovës, duke kontribuar njëkohësisht edhe në përshpejtimin e integritetit të vendit në BE.<sup>12</sup> Për shkak të rëndësisë që ka sektori i bujqësisë në zhvillimin ekonomik të vendit, Qeveria, përkatësisht MBPZhR-ja ka vazhduar ta mbështesë atë në forma të ndryshme, përfshirë edhe subvencionimin e fermerëve. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, kjo Ministri është përgjegjëse për implementimin e subvencioneve, përkatësisht masave në kuadër të skemës kombëtare për bujqësi dhe zhvillim rural. Përmes këtyre subvencioneve deri më tani janë mbuluar subvencionimi për krerë, pagesat për sipërfaqe hektarë për kultura të ndryshme bujqësore dhe subvencionimi për bletari, projekte të

---

Përbashkëta Bujqësore (ii) zhvillim i qëndrueshëm i sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në vendet candidate.

<sup>12</sup> Ministria e Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017*, prill 2014, f. 55.

hortikulturës, sera, përpunim të mishit dhe të qumështit.<sup>13</sup> Përveç këtyre, për zhvillimin e këtij sektori MBPZhR-ja ka përkrahur investimet në sistemin e ujitjes dhe ndërtimin e depove për grumbullimin, klasifikimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore.<sup>14</sup> Këto investime kanë ndikuar që të rritet atraktiviteti i sektorit të bujqësisë, veçanërisht interesimi në viset rurale për kultivimin e prodhimeve bujqësore.

Ky sektor është vendosur si prioritet i Qeverisë dhe shihet si sektor strategjik prandaj edhe buxhetimi i tij është rritur vit pas viti (analizat financiare pasojnë në pjesën në vazhdim të këtij punimi). Por, edhe përkundër kësaj, vlera buxhetore e disponueshme për këtë sektor mbetet e ulët. Për shumë arsye e kryesisht në mungesë të mjeteve financiare, sektori i bujqësisë në Kosovë mbetet në masë të pakënaqshme i trajtuar nga institucionet në vend. Si pasojë e buxhetit të varfër të Kosovës, sfidë e MBPZhR-së mbetet menaxhimi adekuat i buxhetit ekzistues, duke shpenzuar mjetet financiare ashtu siç janë alokuar dhe që i kontribuojnë përmbushjes së prioriteteve të përcaktuara. Bazuar në përvojat e deritanishme, pritet që për shkak të vartësisë nga fondet buxhetore nacionale, Kosova do të vazhdojë të përballlet me vështirësi në financimin shtesë për mbulimin e nevojave për investime në sektorin e bujqësisë. Prandaj, mbështetja e institucioneve ndërkombëtare financiare dhe donatorëve të tjerë (mbështetja financiare dhe teknike) në këtë fushë është e nevojshme, që të vazhdohet trendi i ndërtimit të kapaciteteve institucionale.

Dihet mirëfilli se qëllimi i çdo qeverie është funksionimi normal dhe arritja e qëllimeve të përcaktuara, prandaj për ushtrimin e detyrave dhe realizimin e aktiviteteve të saj në mënyrë të rregullt asaj i nevojitet që mjetet financiare të

---

<sup>13</sup> *Ibid.*

<sup>14</sup> *Ibid.*

mbledhura t'i shpërndajë në mënyrën e duhur dhe t'i përdorë ato me përgjegjësi, në mënyrë eficiente dhe efikase.<sup>15</sup> Sfidë e të gjitha njësisve shpenzuese për menaxhimin efikas të buxhetit mbetet ndërlidhja sa më e plotë e planifikimit me shpenzimet.

Ndërkaq, për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe cilësor buxhetor si dhe për menaxhimin efektiv të buxhetit, përfshirë edhe buxhetin për sektorin e bujqësisë, sipas autorit Isa Mustafa duhet të ndërmerren disa veprime të caktuara si vijon:

të sigurohet një strategji e cila ndërlidhet me prioritetet e përgjithshme dhe me analizat sektoriale;

të sigurohen fondet e nevojshme dhe të mjaftueshme për zbatimin e planeve;

të ndërtohen institucionet në atë mënyrë që të kenë kapacitetin e duhur dhe të jenë të përgjegjshme, që këto fonde t'i shndërrojnë në shërbime cilësore;

të shoqërohet procesi i menaxhimit dhe ekzekutimit të buxhetit me analizat dhe informatat mbi procesin e shpenzimit të fondeve si rezultat i monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm.<sup>16</sup>

Si rrjedhojë e kësaj shihet se menaxhimi i shpenzimit të buxhetit publik është element i rëndësishëm i financave publike. Pikërisht për këtë, pjesa në vazhdim do të fokusohet më shumë në fushëveprimin dhe kapacitetet e MBPZhrR-së si institucion i nivelit qendror në shpenzimin e buxhetit të ndarë dhe orientimin e tij drejt zhvillimit të sektorit të bujqësisë si dhe pengesat gjatë implementimit të mjeteve financiare në përputhje me politikat bujqësore.

---

<sup>15</sup> Artan Nimani, *Menaxhimi i Financave Publike*, Instituti i Statistikës "Rahmil Nuhui", Prishtinë, 2007, f. 87.

<sup>16</sup> Isa Mustafa, *Sistemi buxhetor i Kosovës - Politikat dhe Qëndrueshmëria (raport hulumtues)*, Riinvest, Prishtinë, 2003, f. 23, i disponueshëm në: <http://www.riinvestinstitute.org>.



## ***Fushëveprimi i përgjegjësive të MBPZhR-së***

MBPZhR-ja është organ i lartë i administratës së vendit, që ofron shërbime publike për sektorin e bujqësisë dhe ushtron kompetencat e saj sipas Kushtetutës dhe ligjit. MBPZhR-ja ka përgjegjësi të krijojë politikat dhe të zbatojë ligjet për zhvillimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural në nivel kombëtar siç janë: krijimi dhe zbatimi i ligjit për (i) ujitjen e tokave (ii) shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës, mbrojtjen dhe rregullimin e saj (iii) caktimin e standardeve për prodhimtari dhe mbrojtjen e bimëve, bujqësinë organike dhe promovimin e prodhimit bujqësor (iv) si dhe u ofron këshilla fermerëve në fushën e prodhimit, përpunimit dhe marketingut.<sup>17</sup> Po ashtu, kjo Ministri, në bashkëpunim me institucionet e tjera bën mbikëqyrjen e standardeve shëndetësore që lidhen me sektorin bujqësor si dhe ushtron kontrollin e cilësisë së ushqimit me qëllim të kujdesit ndaj konsumatorit.

Në kuadër të fushëveprimit të saj MBPZhR-ja harton edhe Planin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (më tej: PBZHR) i cili plan përmban Strategjinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural dhe si i tillë miratohet nga Kuvendi i Kosovës për periudhë 7 vjeçare.<sup>18</sup> MBPZhR-ja, e mbështetur nga partnerët e saj së fundmi ka përgatitur Draft-Strategjinë për PBZHR 2014 -2020. Ky plan përshkruan në hollësi shumë nga hapat që duhet të ndërmerret Kosova për të ristrukturuar sektorin e saj agro-rural, drejt përmbushjes së obligimeve me të cilat do të përballlet si vend para kandidat/kandidat dhe pastaj edhe si anëtare e BE-së.

---

<sup>17</sup> Gjerësisht shih: *Rregullorja nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive*, shtojca 14, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, datë 22.03.2011.

<sup>18</sup> Shih: *Ligji nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 56, Prishtinë, 2009, neni 5.

Politika e Zhvillimit Rural të Kosovës 2014-2020 do të orientohet sipas drejtimeve të reja strategjike të politikave të Zhvillimit Rural të BE-së, duke i konsideruar përvojat e fituara gjatë zbatimit të PBZHR-së 2007-2013. Objektivat e deklaruara të PBZHR-së 2014-2020 janë bazuar në objektivat e politikave strategjike të IPA II, duke reflektuar gjithashtu objektivat strategjike të vendit për zhvillimin dhe nevojat specifike të sektorit agro-ushqimor, pylltarisë dhe zonave rurale të Kosovës.<sup>19</sup>

Se sa ambicioz është PBZHR 2014-2020, tregohet nga prioritetet e përcaktuara për zhvillimin agro-rural në Kosovë, e që janë:

nxitja e transferimit të njohurive në inovacion në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale; rritja e konkurrencës në të gjitha llojet e bujqësisë dhe rritja e qëndrueshmërisë së fermës;

nxitja e organizimit të zinxhirit ushqimor dhe menaxhimit të riskut në bujqësi; rivendosja, ruajtja dhe rritja e ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pyjet;

promovimi i efikasitetit të burimeve dhe mbështetja e zhvendosjes drejt një ekonomie me karbon të ulët dhe të përshtatshëm ndaj klimës në sektorët e bujqësisë, ushqimit dhe pyjeve; nxitja e përfshirjes sociale, ulja e varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në zonat rurale.<sup>20</sup>

MBPZhR-ja po ashtu çdo vit harton Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ku përcaktohen skemat dhe masat për mbështetje financiare për pagesa direkte dhe masat për zhvillim rural, i cili program përgatitet në përputhje me Planin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

---

<sup>19</sup> Tina Volk, Emil Erjavec, Kaj Mortensen (redaktorë), *Politika Bujqësore dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore* (përkthim shqip), botuar nga: Food and Agriculture Organization of the United Nations (FAO), Budapest, 2015, f. 129.

<sup>20</sup> *Ibid.*

## **Organizimi i brendshëm dhe misioni i MBPZhR-së**

Në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,<sup>21</sup> MBPZhR-ja ka themeluar strukturën e saj organizative e cila është si vijon: Kabineti i Ministrit, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Departamentet dhe Divizionet në kuadër të departamenteve. MBPZhR-ja nën ombrellën e saj ka dy Agjenci (Agjencia e Pylltarisë së Kosovës dhe Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë),<sup>22</sup> të cilat konsiderohen të jenë organet qendrore të saj me fuqi të agjencive ekzekutive.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (tani e tutje: AZHB) është përgjegjëse për zbatimin e politikave bujqësore dhe politikave të zhvillimit rural të cilat hartohen nga Autoriteti Menaxhues në MBPZhR, si dhe ushtron edhe një sërë funksionesh tjera për administrimin e fondeve për pagesa direkte dhe masat e zhvillimit rural.<sup>23</sup>

MBPZhR-ja është në proces ristrukturimi dhe reformimi të administratës së saj në drejtim të themelimit të strukturave organizatave në përputhje me Politikën e Përbashkëta Bujqësore,<sup>24</sup> në mënyrë që të jenë kompetente për zbatimin e mbështetjes së para-anëtarësimit (IPARD) në kuadër të procesit

---

<sup>21</sup> Kjo rregullore është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ka filluar të zbatohet në vitin 2014.

<sup>22</sup> *Rregullorja (qrk) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.12, Prishtinë, 2014, neni 50.

<sup>23</sup> *Ligji Nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, Prishtinë, 2012, neni 11.

<sup>24</sup> Politika e Përbashkët Bujqësore është një sistem i ndihmave dhe programeve bujqësore të Bashkimit Europian i cili ka për synim (i) rritjen e të ardhurave të popullsisë rurale (ii) rritjen e prodhimit (iii) stabilitetin e tregut (iv) mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe (v) uljen e varfërisë.

të integritimit evropian. Me këtë nënkuptohet pavarësimi i plotë i AZHB-së në ekzekutimin e fondeve për pagesa direkte dhe masat e zhvillimit rural pasi që ekzekutimi i pagesave ende realizohet nga zyra qendrore e financave në MBPZhR. Vlen të ceket se AZHB-ja do të përbejë pjesën kryesore të strukturës institucionale për absorbimin e fondeve IPARD. Por, pavarësisht rëndësisë që ka procesi i ristrukturimit të MBPZhR-së për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, ky proces nuk është i lehtë dhe është duke u përcjellë me sfida të tilla si pamundësia ose vështirësitë për punësimin e personelit të ri për pozitat e kërkuara, mungesa e buxhetit etj.

Analiza e performancës së shpenzimit të buxhetit në MBPZhR gjatë periudhës 2012-2015

Në vijim të këtij punimi do të bëhet prezantimi i analizës mbi performancën e realizimit të buxhetit për MBPZhR-në dhe agjencitë vartëse të saj, destinuar për sektorin e bujqësisë. Si rrjedhojë do të krahasohen shpenzimet aktuale me buxhetin fillestar dhe buxhetin final (buxhetin e rishikuar në fund të çdo viti) me qëllim të paraqitjes së një pasqyre mbi atë se sa janë realizuar objektivat e përcaktuara për këtë sektor. Krahasimi do të bëhet për periudhën financiare 2012-2015 (me raste edhe 2011 bazuar në të dhënat e disponueshme). Të dhënat e paraqitura në këtë punim janë siguruar nga ligjet e buxhetit, raportet vjetore financiare të MBPZhR-së, raportet përmbledhëse të buxhetit përmes Free Balancit dhe raportet e auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, si rezultat i implementimit të buxhetit në MBPZhR. Tabela nr.1 në vijim të këtij punimi prezanton një vështrim mbi performancën e përgjithshme të implementimit të buxhetit të MBPZhR-së në periudhën financiare 2012-2015. Tabela konsiston në pesë kolona për secilin vit. Kolonat janë të emërtuara si në vijim (i) A – përmbledhje e buxhetit të aprovuar (ii) B – përmbledhje e buxhetit të rishikuar në fund të vitit<sup>25</sup> (iii)

---

<sup>25</sup> Ministria e Financave përmes udhëzimeve që i nxjerr, u mundëson si organizatave buxhetore tjera ashtu edhe MBPZhR-së rishikimin e buxhetit në mënyrë që ato të mund të vlerësojnë ecurinë e shpenzimeve deri në atë pikë

C - përmbledhje e buxhetit të shpenzuar (iv) D - raporti në mes të buxhetit të shpenzuar dhe atij të rishikuar (C/B) shprehur në % dhe (v) E - raporti në mes të buxhetit të shpenzuar dhe atij të planifikuar (C/A) shprehur në përqindje, sipas burimeve të financimit, kategorive ekonomike dhe projekteve kapitale brenda MBPZhR-së.

Tabela 1. Realizimi i buxhetit të ndarë për MBPZhR-në në periudhën financiare 2012-2015

MBPZhR (vlerat në '000 EUR)	2012 <sup>26</sup>				
	A	B	C	D	E
<b>Totali</b>	<b>21,409</b>	<b>26,160</b>	<b>22,424</b>	<b>86%</b>	<b>105%</b>
<b>Fondi i Konsoliduar i Kosovës</b>	<b>21,409</b>	<b>26,160</b>	<b>22,424</b>	<b>86%</b>	<b>105%</b>
Grantet Qendrore	21,100	22,613	20,615	91%	98%
Të hyrat vetanake	309	356	204	58%	66%
Huamarrja	-	3,192	1,605	50%	-
Grantet Donatore	-	0.065	-	0%	-
<b>Totali i kategorive ekonomike</b>	<b>21,409</b>	<b>26,160</b>	<b>22,424</b>	<b>86%</b>	<b>105%</b>
Paga dhe Mëditje	1,939	2,145	1,607	75%	83%
Mallra dhe Shërbime	3,024	3,968	2,248	57%	74%
Shërbime Komunale	128	128	98	76%	77%
Subvencione dhe Transfere	8,400	18,223	17,015	93%	203%
Investimet Kapitale	7,919	1,696	1,455	86%	18%

të vitit. Në këtë rast MBPZhR vlerëson aktivitetet dhe shpenzimet e realizuara, si dhe të tjerat të cilat planifikon t'i shpenzojnë deri në mbylljen e vitit fiskal.

<sup>26</sup> Të dhënat numerike për vitin 2012 janë siguruar nga raporti përmbledhës i buxhetit 2012 për MBPZhR-në nxjerrë nga SIMFK si dhe nga tabela 3.1. e buxhetit dhe tabela 3.2. për projektet kapitale të nivelit qendror, aprovuar me Ligjin nr. 04 - L - 079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 30, Prishtinë 2011). Të dhënat janë përpunuar më tutje nga autori.

MBPZhR	2013 <sup>27</sup>				
(vlerat në '000 EUR)	A	B	C	D	E
<b>Totali</b>	<b>23,359</b>	<b>23,534</b>	<b>22,471</b>	<b>96%</b>	<b>96%</b>
<b>Fondi i Konsoliduar i Kosovës</b>	<b>23,359</b>	<b>23,534</b>	<b>22,471</b>	<b>96%</b>	<b>96%</b>
Grantet Qendrore	23,117	17,938	17,232	96%	75%
Të hyrat vetanake	242	391	211	54%	87%
Huamarrja	0	5,205	5,028	97%	-
Grantet Donatore	-	443	0	0%	-
<b>Totali i kategorive ekonomike</b>	<b>23,359</b>	<b>23,534</b>	<b>22,471</b>	<b>96%</b>	<b>96%</b>
Paga dhe Mëditje	1,939	1,889	1,599	85%	83%
Mallra dhe Shërbime	3,024	3,131	2,678	86%	89%
Shërbime Komunale	128	128	94	74%	73%
Subvencione dhe Transfere	9,400	16,499	16,428	100%	175%
Investimet Kapitale	8,869	1,887	1,672	89%	19%

<sup>27</sup> Të dhënat numerike për vitin 2013 janë marrë nga raporti përmbledhës i buxhetit 2013 për MBPZhR-në nxjerrë nga SIMFK si dhe nga tabela 3.1. e buxhetit dhe 3.2. e projekteve kapitale të nivelit qendror, aprovuar me Ligjin nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 36, Prishtinë, 2012). Të dhënat janë përpunuar më tutje nga autori.

*Menaxhimi i mjeteve financiare të MBPZhR-së për sektorin e bujqësisë në Kosovë*

MBPZhR (vlerat në '000 EUR)	2014 <sup>28</sup>				
	A	B	C	D	E
<b>Totali</b>	<b>27,170</b>	<b>28,269</b>	<b>24,159</b>	<b>85%</b>	<b>89%</b>
<b>Fondi i Konsoliduar i Kosovës</b>	<b>27,170</b>	<b>28,269</b>	<b>24,159</b>	<b>85%</b>	<b>89%</b>
Grantet Qendrore	22,362	19,385	17,965	93%	80%
Të hyrat vetanake	259	391	258	66%	100%
Huamarrja	4,550	4,550	2,886	63%	63%
Grantet Donatore	-	3,943	3,049	77%	-
<b>Totali i kategorive ekonomike</b>	<b>27,170</b>	<b>28,269</b>	<b>24,159</b>	<b>85%</b>	<b>89%</b>
Paga dhe Mëditje	1,939	1,991	1,782	90%	92%
Mallra dhe Shërbime	3,304	3,538	3,218	91%	97%
Shërbime Komunale	128	118	95	81%	75%
Subvencione dhe Transfere	11,810	20,402	18,338	90%	155%
Investimet Kapitale	9,989	2,220	726	33%	7%

<sup>28</sup> Të dhënat numerike për vitin 2014 janë siguruar nga raporti përmbledhës i buxhetit 2014 për MBPZhR-në nxjerrë nga SIMFK si dhe nga tabela 3.1. e buxhetit dhe 3.2. për projektet kapitale, aprovuar me Ligjin nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.1, Prishtinë, 2014). Të dhënat janë përpunuar më tutje nga autori.

MBPZhR (vlerat në '000 EUR)	2015 <sup>29</sup>				
	A	B	C	D	E
<b>Totali</b>	<b>60,153</b>	<b>58,801</b>	<b>57,521</b>	<b>98%</b>	<b>96%</b>
<b>Fondi i Konsoliduar i Kosovës</b>	60,153	58,801	57,521	98%	96%
Grantet Qendrore	58,602	53,544	52,643	98%	90%
Të hyrat vetanake	229	329	228	69%	100%
Huamarrja	1,322	1,322	1,207	91%	91%
Grantet Donatore	-	3,606	3,443	95%	-
<b>Totali i kategorive ekonomike</b>	<b>60,153</b>	<b>58,801</b>	<b>57,521</b>	<b>98%</b>	<b>96%</b>
Paga dhe Mëditje	2,292	2,014	1,957	97%	85%
Mallra dhe Shërbime	2,808	3,990	3,692	93%	131%
Shërbime Komunale	109	119	98	83%	90%
Subvencione dhe Transfere	53,574	51,555	50,724	98%	95%
Investimet Kapitale	1,370	1,123	1,050	93%	77%

<sup>29</sup> Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, f. 17 si dhe tabela 3.2. për projektet kapitale, aprovuar me Ligjin nr. 05/L -001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.



*Menaxhimi i mjeteve financiare të MBPZhR-së për sektorin e bujqësisë në Kosovë*

MBPZhR	2012				
<i>(vlerat në '000 EUR)</i>					
<b>Totali i Projekteve Kapitale</b>	<b>7,919</b>	<b>1,696</b>	<b>1,456</b>	<b>86%</b>	<b>18%</b>
Rehabilitimi i sistemit të ujitjes në Kosovë	4,157	526	476	91%	11%
Krijimi i Katastrit të vreshtarisë dhe industrisë së verës në Kosovë	250	250	250	100%	100%
Ndërtimi i tregjeve dhe deponive për grumbullimin, ruajtjen dhe klasifikimin e prodhimeve bujqësore	2,592	-	-	0%	0%
Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura	500	500	484	97%	97%
Hartimi i Planeve Menaxhuese	200	200	200	100%	100%
Blerja e veturave	50	50	46	-	91%
Blerja e veturave	-	-	-	-	-
Aerofotografimi i territorit të vendit	-	-	-	-	-
Ngritja e kapaciteteve laboratorike	-	-	-	-	-
Renovimi i objektit të IBK	-	170	-	-	-
Ndërtimi i pendës mbi lumin Popoc	-	-	-	-	-
Blerja e veturave (BB)	-	-	-	-	-
Rrallimet paratregtare	-	-	-	-	-
Ngritja e pemishtës eksperimentale	30	-	-	-	-
Aktivizimi i sipërfaqes bujqësore të IBK	140	-	-	-	-
Krijimi i kapaciteteve hulumtuese dhe prodhuese të pronave- tokave bujqësore të IBK-ës	-	-	-	-	-

MBPZhR 2013					
(vlerat në '000 EUR)	A	B	C	D	E
<b>Totali i Projekteve Kapitale</b>	<b>8,869</b>	<b>1,886</b>	<b>1,671</b>	<b>89%</b>	<b>19%</b>
Rehabilitimi i sistemit të ujëtjes në Kosovë	3,874	21	0	0%	0%
Krijimi i Katastrit të vreshtarisë dhe industrisë së verës në Kosovë	250	250	250	100%	100%
Ndërtimi i tregjeve dhe deponive për grumbullimin, ruajtjen dhe klasifikimin e prodhimeve bujqësore	3,510	0	0	0%	0%
Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura	550	550	457	83%	83%
Hartimi i Planeve Menaxhuese	300	300	300	100%	100%
Blerja e veturave	50	50	50	100%	100%
Blerja e veturave	0	4	4	100%	
Aerofotografimi i territorit të vendit	65	65	65	100%	100%
Ngritja e kapaciteteve laboratorike	180	166	166	100%	92%
Renovimi i objektivit të IBK	90	138	129	94%	143%
Ndërtimi i pendës mbi lumin Popoc	0	32	0	0%	-
Blerja e veturave (BB)	0	310	250	73%	-
Krallimet paratregtare	-	-	-	-	-
Ngritja e pemishtës eksperimentale	-	-	-	-	-
Aktivizimi i sipërfaqes bujqësore të IBK	-	-	-	-	-
Krijimi i kapaciteteve hulumtuese dhe prodhuese të pronave- tokave bujqësore të IBK-ës	-	-	-	-	-

*Menaxhimi i mjeteve financiare të MBPZhR-së për sektorin e bujqësisë në Kosovë*

MBPZhR 2014					
<i>(vlerat në '000 EUR)</i>	A	B	C	D	E
<b>Totali i Projekteve Kapitale</b>	<b>9,989</b>	<b>2,220</b>	<b>727</b>	<b>33%</b>	<b>7.3%</b>
Rehabilitimi i sistemit të ujitjes në Kosovë	4,659	-	-	-	-
Krijimi i Katastrit të vreshtarisë dhe industrisë së verës në Kosovë	250	250	245	98%	98%
Ndërtimi i tregjeve dhe deponive për grumbullimin, ruajtjen dhe klasifikimin e prodhimeve bujqësore	3,510	0%	0%	-	-
Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura	450	450	44	10%	10%
Hartimi i Planeve Menaxhuese	250	250	151	61%	61%
Blerja e veturave	200	200	0	0%	0%
Blerja e veturave	-	-	-	-	-
Aerofotografimi i territorit të vendit	-	-	-	-	-
Ngritja e kapaciteteve laboratorike	180	180	180	100%	100%
Renovimi i objektit të IBK	300	300	7	2%	2%
Ndërtimi i pendës mbi lumin Popoc	-	-	-	-	-
Blerja e veturave (BB)	-	-	-	-	-
Rrallimet paratregtare	-	400	0	0%	-
Ngritja e pemishtës eksperimentale	-	-	-	-	-
Aktivizimi i sipërfaqes bujqësore të IBK	-	-	-	-	-
Krijimi i kapaciteteve hulumtuese dhe prodhuese të pronave- tokave bujqësore të IBK-ës	190	190	100	52%	52%

MBPZhR 2015					
(vlerat në '000 EUR)	A	B	C	D	E
<b>Totali i Projekteve Kapitale</b>	<b>1,370</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Rehabilitimi i sistemit të ujitjes në Kosovë	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Krijimi i Katastrit të vreshtarisë dhe industrisë së verës në Kosovë	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Ndërtimi i tregjeve dhe deponive për grumbullimin, ruajtjen dhe klasifikimin e prodhimeve bujqësore	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura	450	n/a	n/a	n/a	n/a
Hartimi i Planeve Menaxhuese	250	n/a	n/a	n/a	n/a
Blerja e veturave	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Aerofotografimi i territorit të vendit	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Ngritja e kapaciteteve laboratorike	230	n/a	n/a	n/a	n/a
Renovimi i objektit të IBK	350	n/a	n/a	n/a	n/a
Ndërtimi i pendës mbi lumin Popoc	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Blerja e veturave (BB)	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Rrallimet paratregtare	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Ngritja e pemishtës eksperimentale	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Aktivizimi i sipërfaqes bujqësore të IBK	-	n/a	n/a	n/a	n/a
Krijimi i kapaciteteve hulumtuese dhe prodhuese të pronave- tokave bujqësore të IBK-ës	90	n/a	n/a	n/a	n/a

Nga tabela nr. 1 e prezantuar më lart shihet se shkalla e ekzekutimit të buxhetit në raport me buxhetin e rishikuar nuk ka pësuar ndryshime të dukshme me kalimin e viteve, duke shënuar një rritje në vitin 2013, përderisa viti 2014 shihet të jetë viti me performancën më të dobët të implementimit të buxhetit, megjithatë me një rritje të dukshme në vitin 2015 prej 98%. Norma më e lartë e ekzekutimit të buxhetit është realizuar në kategorinë ekonomike “subvencione dhe transfere”, e cila kategori njëherësh ka pjesëmarrjen më të lartë në buxhetin e përgjithshëm të Ministrisë në secilin vit. Në raport me planifikimin, shkalla e shpenzimit në këtë kategori është dukshëm më e lartë, ku në vitin 2012 ka arritur ta tejkalojë atë me 203%. Nëse i shohim investimet kapitale në raport me planifikimin vërejmë një diferencë të madhe në ekzekutim prej 7.3% në vitin 2014, duke ndikuar që ato të implementohen në

normë shumë të ulët (18% në normë të përgjithshme në vitin 2012, 19% në vitin 2013 duke vazhduar me 7.3 % në 2014). Pavarësisht rëndësisë që ka projekti kapital “Rehabilitimi i sistemit të ujitjes në Kosovë” në krijimin e sektorit të qëndrueshëm agro-rural me karakter miqësor ndaj mjedisit, ai ka vazhduar të implementohet në normë relativisht të ulët, ku në vitin 2012 është ekzekutuar me 11%, në vitit 2013 dhe 2014 me 0%.<sup>30</sup>

Në anën tjetër, rëndësia e projektit kapital “Ndërtimi i tregjeve dhe deponive për grumbullimin, ruajtjen dhe klasifikimin e prodhimeve bujqësore” shihet në ndërlidhjen më të mirë të prodhimit me tregun e brendshëm dhe industrinë agro-përpunuese, duke nxitur edhe eksportin si dhe funksionimin e shumë kapaciteteve për investime në prodhime, duke ndikuar kështu edhe në krijimin e vendeve të punës dhe në kursime nga importi.<sup>31</sup> Për më tepër “...pasi një ndër synimet kryesore të politikave bujqësore të Kosovës në rend të parë është rritja e sasisë dhe cilësisë së produkteve bujqësore, është domosdoshmëri e kohës që MBPZhR-ja ta mbështesë edhe më tutje investimin në ndërtimin e pikave grumbulluese të produkteve, ku do të bëhet jo vetëm grumbullimi, por edhe kontrolli, klasifikimi, ambalazhimi, etiketimi dhe ofrimi në treg i produkteve vendore për një periudhë më të gjatë kohore”.<sup>32</sup> Pavarësisht kësaj, nga tabela nr.1 shihet se ky projekt kapital ka vazhduar të zbatohet në normë 0% gjatë kësaj periudhe kohore. Devijimi i madh midis buxhetit të planifikuar dhe atij të shpenzuar për këtë kategori të shpenzimeve rrjedh kryesisht nga transferimi i mjeteve financiare nga kjo kategori në “subvencione

---

<sup>30</sup> Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural*, Prishtinë, 2010, f. 107.

<sup>31</sup> Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Raporti i Gjellbër 2015*, dhjetor 2015, f. 20.

<sup>32</sup> *Ibid.*

dhe transfere”, në mungesë të fondeve të mjaftueshme. Ndër të tjera, arsye të mosshpenzimit të kapitaleve janë edhe vonesat në procedurat e prokurimit, e që e ngrit nevojën e përmirësimit të prokurimit publik. Si pasojë nga e gjithë kjo po dëmtohet sektori i bujqësisë, për faktin se investimet kapitale janë zhvillues të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë të këtij sektori.

Nga tabela e prezantuar më lart po ashtu del se kategoria “paga dhe mëditje” nuk është ekzekutuar plotësisht, për faktin e mosplotësimit të vendeve të punës siç është aprovuar me buxhet për arsye të ndryshme. Edhe pse është shumë e nevojshme, siç duket MBPZhR-ja ka hasur në vështirësi në punësimin e personelit të ri. Nevojën për rekrutim të personelit shtesë e thekson procesi i riorganizimit të MBPZhR-së, e aq më tepër procesi i akreditimit të AZHB-së për implementimin e fondeve IPARD.

Po ashtu, nga prezantimi i të dhënave në këtë tabelë shihet qartë se për kategoritë ekonomike “shërbimet komunale” dhe “mallrat e shërbimet”, shkalla e ekzekutimit nuk ka shënuar ndonjë ndryshim të dukshëm përveç se në vitin 2012, ku “mallrat dhe shërbimet” kanë pësuar një rënie të konsiderueshme duke u realizuar në shkallë prej 56.7%.

Si përfundim, mund të konstatojmë se performanca e ekzekutimit të buxhetit në nivel të Ministrisë për periudhën e përmendur më lart konsiderohet të jetë e mirë, me mundësi të përmirësimit të mëtejme. Por, duhet të theksohet se shpenzimi i buxhetit në këtë periudhë kohore nuk është orientuar plotësisht siç është planifikuar. Prandaj, duhet të punohet edhe më tej në të ardhmen drejt ngritjes së kapaciteteve për përmirësimin e planifikimit të buxhetit në përputhje me politikat bujqësore.

## Rritja vjetore e shpenzimeve në MBPZhR

Bazuar në të dhënat nga ligjet vjetore të buxhetit për periudhën 2011-2015 mund të konstatojmë se pjesëmarrja e shpenzimeve të përgjithshme të MBPZhR-së në raport me buxhetin nacional është rritur lehtësisht me kalimin e kohës. Kjo mund të vërehet edhe nga paraqitja e të dhënave që kanë të bëjnë me rritjen vjetore të shpenzimeve në terma nominal të kësaj Ministrie të prezantuara në tabelën nr. 2.

Tabela 2. Rritja vjetore e shpenzimeve në terma nominal MBPZhR 2011-2015.<sup>33</sup>

(000' Euro)	Shpenzimet 2011	Shpenzi met 2012	Shpenzi met 2013	Shpenzi met 2014	Shpenzi met 2015
<b>Ministria e Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural</b>	<b>12,688</b>	<b>22,424</b>	<b>22,471</b>	<b>24,159</b>	<b>57,521</b>
Pagat dhe mëditjet	1,466	1,607	1,599	1,782	1,957
Mallrat dhe shërbimet	1,644	2,248	2,678	3,218	3,692
Shërbimet komunale	89	98	94	95	98
Subvencionet dhe transfere	7,806	17,015	16,428	18,338	50,724
Shpenzimet kapitale	1,684	1,455	1,672	726	1,050
Obligimet e papaguara	183	492	12,024	18,724	n/a
Rritja nominale vjetore e shpenzimeve buxhetore	-	77%	0%	8%	138%
Rritja nominale vjetore e shpenzimeve operative	-	91%	-1%	13%	141%
Rritja nominale vjetore e shpenzimeve kapitale	-	-14%	15%	-57%	45%
Rritja nominale vjetore e obligimeve	-	169%	2344%	55,7%	-
Shpenzimet e përgjithshme si përqindje e buxhetit nacional	1%	2%	1%	2%	4%

<sup>33</sup> Bazuar në të dhënat nga Ligjet Vjetore të Buxhetit (2011-2015). Buxheti i shpenzuar i MBPZhR pjesëtuar me buxhetin e përgjithshëm qeveritar.

Nga paraqitja e të dhënave në tabelën nr.2 del se rritja vjetore e shpenzimeve buxhetore në terma nominal në nivel të përgjithshëm të kësaj Ministrie tregon performancë pozitive. Rritja më e lartë është shënuar në vitin 2012, ku buxheti i shpenzuar në krahasim lartë, dhe ka vazhduar të jetë relativisht konstant për vitet në vijim me përjashtim të vitit 2015, i cili është dukshëm më i lartë. Kësaj i ka kontribuar në një masë të caktuar edhe vendimi i Qeverisë, me të cilin ka pasur rritje të buxhetit për kategorinë “subvencione dhe transfere” për 138% në vitin 2015 në krahasim me ndarjet buxhetore të vitit 2014. Ndërkaq, duhet theksuar se rritja vjetore e shpenzimeve kapitale nuk shfaqet kënaqshëm, me performancë më të theksuar negative në vitin 2014 me -57%. Në anën tjetër, me rritjen e shpenzimeve në të njëjtën kohë janë rritur edhe detyrimet (obligimet e papaguara). Shuma më e lartë e borxheve është akumuluar në vitin 2013 dhe 2014. Nëse krahasohen buxheti i vitit 2012 dhe 2013, atëherë shihet një rritje shumë e madhe në totalin e detyrimeve të papaguara. Me shumën totale prej 12 milion eurosh detyrime në fund të vitit fiskal 2013, MBPZhR-ja në fakt e ka përfunduar vitin me borxh buxhetor apo deficitit prej 53.4%. Këto detyrime janë bartur në vitin 2014 i cili vit është mbyllur me deficit buxhetor 77,5 %. Kjo mund të vërehet qartë nga prezantimi i të dhënave në tabelën nr.3. me vitin paraprak është për 77% më i lartë



Tabela 3. Obligimet e papaguara të MBPZhR-së për periudhën 2011-2015 sipas kategorive ekonomike.<sup>34</sup>

Vlera ne 000' Euro	2011	2012	2013	2014	2015	2011-2014
Totali	183	492	12,024	18,724	n/a	31,423
Paga dhe mëditje	-	-	-	-	n/a	-
Mallra dhe shërbime	88	44	50	430	n/a	612
Shpenzime Komunale	5	6	5	8	n/a	24
Subvencione dhe transfere	90	377	11,966	12,285	n/a	24,718
Investime kapitale	-	65	2	2	n/a	67

Nga tabela nr.3 vërehet qartë se MBPZhR-ja ka krijuar obligime në të gjitha kategoritë, përpos në paga dhe mëditje. Obligimet më të mëdha të krijuara janë në kategorinë “subvencione dhe transfere”. Kjo ka ndodhur për shkak se numri i fermerëve që kanë aplikuar për subvencione dhe të cilët kanë përmbushur kriteret e vendosura ka tejkaluar dukshëm numrin e planifikuar. Me këtë rast MBPZhR-ja është obliguar që t’u ofrojë subvencione fermerëve që kanë përmbushur kriteret e përcaktuara, përderisa ekzistojnë kërkesa ligjore me rastin e përmbushjes së kriterëve. MBPZhR-ja si zgjidhje ka gjetur transferimin e mjeteve financiare nga “investimet kapitale” në “subvencione dhe transfere” duke i lënë disa projekte kapitale pa u implementuar. Obligimet e papaguara janë bartur nga viti në vit dhe kanë qenë prioritet mbi shpenzimet tjera. Nga e gjithë kjo, konsideroj se arsyeja e akumulimit të obligimeve ka qenë kryesisht mungesa e mjeteve financiare.

<sup>34</sup> Të dhënat janë siguruar nga Raportet Vjetore Financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2011-2014.

Ndërkaq, nëse shikojmë pjesëmarrjen e shpenzimeve të Ministrisë sipas kategorive ekonomike del se pjesëmarrja më e madhe e shpenzimeve është destinuar për kategorinë ekonomike “subvencione dhe transfere”. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike janë të prezantuara në figurën nr.1 si më poshtë.




Figura 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike MBPZhR 2011-2015

Nga figura nr.1 vërehet se ka pasur dallime të mëdha në pjesëmarrjen e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike. Kështu, pjesa më e madhe e shpenzimeve për këtë periudhë kohore janë destinuar për kategorinë ekonomike “subvencione dhe transfere” e cila ka vazhduar të shënojë trend rritës, duke ndikuar kështu lehtësisht në zhvillimin e bujqësisë dhe në përgjithësi edhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës, përderisa investimet kapitale kanë shënuar rënie. Mallrat dhe shërbimet janë rritur lehtësisht, kurse shpenzimet për paga dhe mëditje dhe shërbimet komunale kanë qenë relativisht konstante me kalimin e viteve për faktin se këto nivele janë të përcaktuara më parë, janë

vështirë të ndryshueshme nga niveli i aktivitetit dhe i ngarkohen Ministrisë në baza të rregullta.

## ***Përfundime***

Bujqësia në Kosovë ka rëndësi shumë të madhe, edhe pse me këtë buxhet modest është e pamundur të adresohen dhe zgjidhen të gjitha sfidat. Mbështetja buxhetore për bujqësinë pritet të ndryshojë gradualisht me integrimin në BE dhe me të fituarit e të drejtës së shfrytëzimit të fondeve të Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural (IPARD). AZHB-ja, e cila tashmë është drejt pavarësimit në përputhje me rregullat dhe procedurat IPARD, përveç zbatimit të masave në kuadër të skemës kombëtare do të jetë përgjegjëse edhe për zbatimin e fondeve të BE-së. Kjo agjenci është në procesin e konsolidimit të strukturës së saj organizative, që nënkupton se akoma nuk është bërë decentralizimi i plotë i funksioneve financiare. Si rrjedhojë ekzekutimi i pagesave për grante të zhvillimit rural dhe pagesa direkte është kryer dhe vazhdon të kryhet nga Zyra e financave në Ministri duke rezultuar në vonesa të pagesave dhe mbingarkesë të punës administrative për AZHB-në. Për më tepër kjo ndikon në ngecje në procesin e zhvillimit të bujqësisë për faktin se pavarësia e AZHB-së në menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e subvencionimit është parakusht për të përfituar nga fondet e BE-së të cilat janë të destinuara për zhvillimin e bujqësisë me qëllim të arritjes së qëndrueshmërisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural. Një administratë publike efikase është shumë e rëndësishme për funksionimin e Politikës së Përbashkët Bujqësore, prandaj është i rëndësishëm konsolidimi i strukturës së saj organizative dhe decentralizimi i plotë i funksioneve financiare dhe të auditimit.

Mbështetja e BE-së në sektorin e bujqësisë do të zgjidhte problemin e pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare.

Një fushë tjetër e cila kërkon vëmendje të veçantë është rishikimi i kontrollit financiar të shpenzimeve. Realizimi i buxhetit kërkon përmirësime, me vëmendje në kategorinë e investimeve kapitale e cila shfaq devijime të konsiderueshme me planifikimin fillestar. Kjo kërkon ndërmarrjen e aktiviteteve në drejtim të një planifikimi më real sa u përket “investimeve kapitale” dhe “subvencioneve e transfereve”. Duhet të sigurohet një proces strikt i vlerësimit dhe planifikimit të buxhetit që do të mundësonte përmbushjen e objektivave të Ministrisë dhe evitimin e akumulimit të obligimeve të papaguara dhe deficitit buxhetor si dhe të shmanget suficiti i paplanifikuar nga mosrealizimi i buxhetit. Suficiti buxhetor lidhet edhe me kapacitetet e pamjaftueshme njerëzore sidomos në AZHB, për menaxhimin e duhur të mjeteve të alokuara.

Në këtë kontekst, në pamundësi të rritjes së financimit, sugjerohet që si pjesë e formulimit të buxhetit vjetor dhe afatmesëm të merret parasysh ndikimi i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Po ashtu rekomandohet të mundësohen ndryshime në vlerat monetare të përcaktuara për masat dhe nënmasat në këtë Program në përpjestim me numrin e fermerëve që plotësojnë kriteret e caktuara, në mënyrë që të evitohet tejkalimi i shumave të aprovuara dhe në këtë mënyrë të shmangen obligimet.

Sa u përket investimeve kapitale shihet se ekziston gjithnjë e më shumë nevoja për financimin e tyre e sidomos të atyre më thelbësore (rehabilitimi sistemit të ujitjes, konsolidimi i tokave, ndërtimi i tregjeve dhe deponive për grumbullimin, ruajtjen dhe klasifikimin e prodhimeve bujqësore) duke marrë parasysh rëndësinë e tyre. Rëndësia e zbatimit të këtyre projekteve kapitale qëndron në standardizimin e prodhimeve bujqësore dhe

certifikimin e cilësisë së tyre, nxitjen e kapaciteteve prodhuese dhe rritjen e produktivitetit, përdorimin me efikasitet të faktorëve të prodhimit (produktiviteti në vend më i ulët se mesatarja në BE për shkak të fragmentimit të lartë të fermave), krijimin e vendeve të reja të punës e në të njëjtën kohë edhe rritjen e eksportit dhe rritjen e të ardhurave të fermerëve.

Forcimi i kapacitetit administrativ të administratës bujqësore, në veçanti në fushën e formulimit të politikave bujqësore, analizimit, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe kontrollit, e bën të mundur sigurimin e një shërbimi publik efikas dhe menaxhimin e politikave bujqësore. Rritja e cilësisë së raportimit duke i involvuar më tepër indikatorët kyç të performancës, të cilët lehtësojnë procesin e vendimmarrjes si dhe mundësojnë buxhetimin e orientuar në rezultate, do të ndikonte dukshëm në menaxhimin e përgjithshëm efektiv të shpenzimeve dhe në rritjen e transparencës së punës së MBPZhR-së.

Drejt rritjes së kapaciteteve institucionale, në mungesë të transparencës, është rekomanduar vazhdimisht nga Komisioni Evropian që të punohet në rritjen e transparencës buxhetore. Aktualisht, struktura buxhetore e MBPZhR-së, duke qenë instanca më e lartë në sektorin e bujqësisë, nuk ofron ndërlidhjen e politikave afatgjata me buxhetin. Nga vështrimi i strukturës aktuale programore të buxhetit në sektorin e bujqësisë vërehet se programet kryesore konstitojnë në nën-programe të njëjta. Kjo strukturë nuk ofron pamje të qartë të buxhetit prandaj sipas praktikave më të mira preferohet që të aplikohet një qasje e re e klasifikimit programor e cila do të bënte ndërlidhjen e politikave afatgjata me buxhetin. Qëllimi është të sigurohet një skemë që do të kontribuonte në një vlerësim, raportim dhe transparencë më të lartë të buxhetit. Aktualisht, në sektorin e bujqësisë ekzistojnë klasifikime të ndryshme për periudhë afatgjatë, afatmesme (KASH) dhe afatshkurtër (plane vjetore financiare). Për këtë

arsye kësaj çështjeje i është ofruar edhe asistencë teknike, dhe po punohet në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të ofruara nga kjo asistencë.

Në zgjidhjen e vështirësive dhe sfidave në sektorin e bujqësisë, e në të njëjtën kohë edhe në zhvillimin ekonomik të vendit, është i domosdoshëm edhe një bashkëpunim dhe koordinim më i ngushtë ndër-qeveritar. Roli i subvencionimit të fermerëve dhe rëndësia e investimeve kapitale në bujqësi do të rritej me përmirësimin e politikave fiskale dhe doganore për zhvillim të tregut vendor dhe depërtim në tregjet e jashtme. Po ashtu kërkohen përmirësime në infrastrukturën rurale, për të mbështetur zhvillimin e biznesit si dhe investime për përmirësimin e cilësisë së edukimit dhe trajnimit të fermerëve.

Pavarësisht gjendjes aktuale, sektori i bujqësisë parashihet të vendoset në një pozitë më të favorshme në të ardhmen. Me rritjen e buxhetit të ndarë për këtë sektor do të rritet numri i përfitueseve të granteve investuese dhe të subvencioneve, do të vazhdojë mbështetja për sektorët që janë mbështetur viteve të kaluara e po ashtu do të mundësohet zgjerimi i mbështetjes për sektorët tjerë. Nga përfitimi i fondeve të BE-së, pritet të ketë një zhvillim të madh në sektorin e bujqësisë, e që do të kishte efekte pozitive edhe në zhvillimin gjithëpërfshirës ekonomik të vendit. Së këndejmi është detyrë e institucioneve të vendit që të punojnë më intensivisht drejt adresimit dhe zgjidhjes së vështirësive që kanë të bëjnë me sektorin e bujqësisë.

## ***Bibliografia***

Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Regjistrimi i Bujqësisë në Republikën e Kosovës 2014*, (rezultatet përfundimtare), Prishtinë, 2014.

*Menaxhimi i mjeteve financiare të MBPZhR-së për sektorin e bujqësisë në Kosovë*

Bukovec, Sonja. *Manual for Budget and Accounting-Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development*, (material i pabotuar), Prishtinë, MBPZhR, korrik, 2014.

European Commission, *Kosovo\* 2016*, Brussels, 9.11.2016.

*Ligji 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 56, Prishtinë 2009.

*Ligji Nr 04 - L - 079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 30, Prishtinë 2011.

*Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.27, Prishtinë, 2008.

*Ligji nr. 04/L-001 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011.

*Ligji Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 36, Prishtinë 2012.

*Ligji Nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.1, Prishtinë 2014.

*Ligji Nr. 05/L -001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.3, Prishtinë 2015.

*Ligjin Nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, Prishtinë 2012.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2010-13*, Prishtinë, 2010.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Raporti i Gjellbër 2015*, dhjetor 2015.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Raporti i obligimeve të papaguara të MBPZhR-së për muajin dhjetor 2014*, Prishtinë, 2014 (material i pabotuar).

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Raporti Vjetor Financiar i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2012* (material i pabotuar).

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, *Raporti Vjetor Financiar i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2013* (material i pabotuar).

Ministria e Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2014-2016*, prill 2013.

Ministria e Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017*, prill 2014.

Ministria e Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019*, prill 2016.

Ministria e Financave, *Raporti përmbledhës i buxhetit 2011 për MBPZhR-në nxjerrë nga SIMFK, Prishtinë, 2011.*

Ministria e Financave, *Raporti përmbledhës i buxhetit 2012 për MBPZhR-në nxjerrë nga SIMFK, Prishtinë, 2012.*

Ministria e Financave, *Raporti përmbledhës i buxhetit 2013 për MBPZhR-në nxjerrë nga SIMFK, Prishtinë, 2013.*

Ministria e Financave, *Raporti përmbledhës i buxhetit 2014 për MBPZhR-në nxjerrë nga SIMFK, Prishtinë, 2014.*

Ministria e Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2013-2015*, prill 2012.

Mustafa, Isa. *Sistemi buxhetor i Kosovës - Politikat dhe Qëndrueshmëria* (raport hulumtues), Prishtinë, Riinvest, 2003. I disponueshëm në: <http://www.riinvestinstitute.org>.

Nimani, Artan. *Menaxhimi i Financave Publike*, Prishtinë, Instituti i Statistikës "Rahmil Nuhiu", 2007.

*Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011*, publikuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Prishtinë, 2012.



*Menaxhimi i mjeteve financiare të MBPZhR-së për sektorin e bujqësisë në Kosovë*

*Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2012, publikuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Prishtinë, 2013.*

*Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2013, publikuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Prishtinë, 2014.*

*Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, publikuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Prishtinë, 2016.*

*Rregullorja (QRK) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.12, Prishtinë, 2014.*

*Rregullorja nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, shtojca 14, botuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, datë 22.03.2011.*

*Tina Volk, Emil Erjavec, Kaj Mortensen (redaktorë). Politika Bujqësore dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore (përkthim shqip), botuar nga: Food and Agriculture Organization of the United Nations (FAO), Budapest, 2015.*

Web-faqe:

<http://oag-rks.org/> (vizituar së fundi: 20.02.2017).

<http://www.oecd.org/governance/budgeting/44683588.pdf> (vizituar së fundi: 09.04.2017).

<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/bruto-produkti-vendor-bpv-sipas-aktiviteteve-ekonomike-dhe-me-qasjen-e-shpenzimeve-2015> (vizituar së fundi: 17.04.2017).

